



SHKODËR

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



+355 4 22 555 14



+355 68 20 59 301



gadc@gadc.org.al



www.popalbania.info



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamez, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje të shumë të nevojshme të ofertave të partitë politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz
- Epoka e Re, Fier
- Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec
- Lëvizja "Mjaft"

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Për identifikimin e prioriteteve të komunitetit për Bashkinë Shkodër në mars 2019 u zhvilluan 6 Forume me banorë të rajoneve të qytetit të Shkodrës, Bërdicës, Gurit të Zi, Dajçit dhe Postribës. Në Forume u diskutuan 22 çështje me interes për komunitetet lokale, si dhe u identifikuan prioritetet në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Në forume pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht 22 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 22 çështjeve objekt diskutimi qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që në këndvështrimin e tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;



26 janë prioritetet e formuluar dhe të listuara sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti prezan-tohen gjerësisht në vijim dhe për përmbushjen e tyre do të lobohet me të zgjedhurit ven-dorë. Përmbushja e këtyre prioriteteve në praktikë do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE ●

Janë **13 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR



- Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave
- Programe për mbështetjen e fermerëve
- Niveli i taksave tarifave në raport me shërbimin

SHËRBIMET PUBLIKE



- Transporti publik
- Shkollat
- Ndriçimi
- Pastrimi
- Gjelbërimi
- Kanalet kulluese dhe vaditëse
- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Infrastruktura, rrugë dhe trotuare

DIMENSIONI SOCIAL



- Programe dhe shërbime për individët në nevojë

DEMOKRACIA VENDORE



- Pjesëmarrja në vendimarrje

● Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE ●

Janë **9 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR



- Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës
- Pagesa e taksave nga qytetarët

SHËRBIMET PUBLIKE



- Kopshtet dhe çerdhet
- Pyjet dhe kullotat

DIMENSIONI SOCIAL



- Programe dhe shërbime mbi adresimin e dhunës në familje
- Pjesëmarrja e grave në vendimarrje
- Romët dhe Egjiptianët

DEMOKRACIA VENDORE



- Transparenca në vendimarrje
- Informimi dhe komunikimi

● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

NXITJA E BIZNESEVE TË TË RINJVE DHE GRAVE

Vlerësimi i përgjithshëm i pjesëmarrësve në forumet e rajoneve të qytetit Shkodër ishte se Bashkia nuk ka programe specifike për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave. Ata e konsiderojnë si një çështje prioritare angazhimin e Bashkisë në këtë këndvështrim si një mënyrë që ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm mbi gratë dhe të rinjtë, por edhe tek punësimi në përgjithësi.

Prioritet 1. Krijimi i inkubatorëve të biznesit si zona pa taksa për të rinjtë që kanë ide kreative dhe novatore në zhvillimin e biznesit

Prioritet 2. Krijimi i incentivave mbështetëse nëpërmjet programeve të specializuara për mbështetje financiare për startup-et rinore

PROGRAME PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE

Në Forumet e njësive administrative Bërdicë, Dajç, Gur i Zi dhe Postrinë ku u diskutua mbi programet për mbështetjen e fermerëve, u theksua nevoja për egzistencën dhe zbatimin e programeve të tilla. Në forumet e njësive administrative Dajç dhe Gur i Zi pjesëmarrësit u shprehën se ka programe për mbështetjen e fermerëve, por mbështetja është minimale. Ndërkohë në njësitë administrative Bërdicë dhe Postrinë pjesëmarrësit nuk kanë dijeni për egzistencën e këtyre programeve. Në këndvështrimin e tyre mungesa e programeve mbështetëse lidhet me mungesën e certifikatave të pronësisë mbi tokën.

Prioritet 3. Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të çertifikimit të pronësisë mbi tokën

NIVELI I TAKSAVE/TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Në të gjitha forumet ku u diskutua mbi këtë çështje pjesëmarrësit u shprehën se niveli i taksave është shumë i lartë krahasuar me cilësinë e shërbimit që marrin praktikisht. Rivlerësimi i nivelit të taksave në konsultim me komunitetin u vlerësua i rëndësishëm nga pjesëmarrësit në forume.

Prioritet 4. Rivlerësim i nivelit të taksave dhe tarifave vendore përmes një procesi konsultues me banorët



● SHËRBIMET PUBLIKE ●

TRANSPORTI PUBLIK

Probleme me transportin u raportuan nga të katër njësitë administrative Bërdicë, Dajç, Gur i Zi dhe Postribë. Në forumin e Dajçit pjesëmarrësit theksuan se *"Transporti ndërrurban publik nuk egziston apo në disa raste është formal dhe jo në cilësinë e duhur. Transporti i organizuar në mënyre private nga operatorë të ndryshëm është i paaksesueshëm dhe kaotik"*.

Prioritet 5. Organizimi i shërbimit të transportit në përputhje me nevojat e komuniteteve të njësive administrative

SHKOLLAT

Nevoja për mirëmbajtje dhe ndërhyrje në shkollat egzistuese u theksua në të gjitha forumet e zhvilluara. Në rajonet e qytetit Shkodër pjesëmarrësit theksuan nevojën për të adresuar problematika të tilla në shkollat egzistuese si: mungesa e ngrohjes, ndriçimi i dëmtuar, mjetet didaktike të papërshtatshme (banka, karrige, derrasa), Ata theksuan gjithashtu se duhet investim në shkolla profesionale.

Në forumin e Dajçit pjesëmarrësit u shprehën se shkolla është në gjendje të mjerueshme për shkak të mungesës së investimeve. Në forumin e Gurit të Zi u vlerësua investimi që po kryhet në shkollën e mesme në terrene sportive dhe ujësjellës, por u theksua se ambjentet e brendshme kanë nevojë për ndërhyrje emergjente. Mungesa e investimeve në shkolla dhe e mirëmbajtjes së tyre u theksua gjithashtu edhe në forumet e Bërdicës dhe Postribës.

Prioritet 6. Mirëmbajtja e shkollave egzistuese dhe plotësimi me mjete didaktike. Me prioritet investime në shkollën e njësisë administrative Dajç për shkak të gjendjes shumë të keqe të saj.

NDRIÇIMI

"Megjithëse ka përmirësime në ndriçimin e qytetit, ka ende zona që nuk janë sa duhet të ndriçuara", - theksuan pjesëmarrësit në Forumet e rajoneve të qytetit Shkodër. Në mënyrë të veçantë ata theksuan nevojën për ndriçim më të mirë në zonat periferike të qytetit. Mungesa e ndriçimit u theksua gjithashtu në forumet e njësive administrative.

Prioritet 7. Përmirësim i ndriçimit në qytetin e Shkodrës dhe njësitë administrative Bërdicë, Gur i Zi, Dajç dhe Postribë

PASTRIMI

Në Forumet e rajoneve të Shkodrës pjesëmarrësit theksuan se cilësia e pastrimit duhet të rritet. Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve dhe e pastrimit është e pamjaftueshme, sikurse duhet shtuar numri i koshave për mbetjet. Edhe në forumet e njësive administrative Dajç, Bërdicë, Gur i Zi dhe Postribë u theksua nevoja për rritjen e cilësisë së pastrimit. Në forumet e Bërdicës dhe në Postribë u theksua se me përjashtim të qendrës së njësisë në fshatra frekuenca e pastrimit është e pamjaftueshme. Në forumin e Dajçit pjesëmarrësit e lidhnin cilësinë e pastrimit si me pamjaftueshmërinë e shërbimit që kryen kompania e pastrimit, ashtu edhe me vetë mungesën e kujdesit nga banorët. Përveçse rritjes së cilësisë së pastrimit pjesëmarrësit në forumin e Gurit të Zi theksuan se edhe koshat për mbeturinat janë të pamjaftueshme.

Prioritet 8. Përmirësim i cilësisë së pastrimit dhe shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave në qytetin e Shkodrës dhe njësitë administrative Bërdicë, Gur i Zi, Dajç dhe Postribë

GJELBËRIMI

Nevoja për të rritur sipërfaqet e gjelbërta dhe për të shtuar parqet u theksua në forumet e rajoneve të Shkodrës, u theksua gjithashtu që vemendja të spostohet edhe në periferi dhe jo vetëm në qendër të qytetit. Në njësinë administrative Dajç krijimi i hapësirave të gjelbërta shihet gjithashtu si një domosdoshmëri për komunitetin.

Prioritet 9. Vijimi i zgjerimit të hapësirave të gjelbërta dhe veçanërisht ndërhyrje për gjelbërim në rrugët dytësore të qytetit dhe në njësinë administrative Dajç

KANALET KULLUESE DHE VADITËSE

Problemet më të mëdha me kanalet kulluese e vaditëse u raportuan në forumin e njësisë administrative Bërdicë, ku sipas pjesëmarrësve kanalet janë jashtë funksionit dhe nuk ka pasur investime. Në Dajç u theksua nevoja e mirëmbajtjes në vijim të kanaleve egzistuese, si dhe hapjes së kanaleve të reja. Në forumin e Gurit të Zi u theksua nevoja për të mirëmbajtur kanalet dytësore për vaditjen e tokave bujqësore, ndërsa në Postribë pastrimi i kanaleve kulluese ishte në proces.

Prioritet 10. Pastrim dhe mirëmbajtje e vazhdueshme e kanaleve kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative Bërdicë, Gur i Zi, Dajç dhe Postribë

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Furnizimi me ujë të pijshëm nuk është i njëjtë në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Sipas pjesëmarrësve në forume në disa zona të qytetit furnizimi me ujë mundësohet me orare, sikurse ka zona ku uji ka probleme me erën dhe sasinë e tepërt të klorit. Në Bërdicë dhe në Postrribë furnizimi me ujë është i limituar në kohë. Ndërkohë në forumet e Dajçit dhe të Gurit të Zi u theksua se shqetësim kryesor ishte fakti që një numër fshatrash nuk furnizohen nga ujësjellësi, por përdorin burime private (shpim), që në disa raste ka rrezik për kontaminin.

Prioritet 11. Përmirësim i furnizimit me ujë të pijshëm dhe cilësisë së ujit.

Prioritet 12. Furnizim me ujë i fshatrave të njësive administative Dajç dhe Gur të Zi të cilat aktualisht nuk furnizohen me ujë nga ujësjellësi

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

"Pavarësisht nga ndërhyrjet në infrastrukturë, është i nevojshëm vijimi i investimeve në infrastrukturën rrugore dhe sinjalistikë në qytetin e Shkodrës", theksuan pjesëmarrësit në forumet e zhvilluara me rajonet e këtij qyteti. Ndërhyrjet kryesore në këndvështrimin e tyre përfshijnë në mënyrë të veçantë rregullimin dhe mirëmbajtjen e trotuarve, vendosjen e sinjalistikës

rrugore. Pjesëmarrësit në forume theksuan nevojën për investime në fusha sporti, ambiente rekreative, sikurse të korsive për lëvizjen me biçikletë. Ata theksuan gjithashtu se pastrimi i liqenit duhet të jetë i vazhdueshëm, sikurse dhe zgjidhjen e problemit të kafshëve endacake që janë një tjetër problem për qytetin. Në Forumin e Bërdicës, Gurit të Zi, Dajçit dhe Postrribës pjesëmarrësit shprehën shqetësim për mungesën e investimeve në rrugët dytësore dhe cilësia e rrugëve lidhëse që është e dobët. Trotualet dhe sinjalistika gjithashtu u cilësuan problematike. Në forumin e Dajçit pjesëmarrësit theksuan se duhet një zgjidhje përfundimtare për problemin e përmytjeve, sikurse ndalimin e plotë të ndërtimeve pa leje.

Prioritet 13. Vijimi i investimeve dhe ndërhyrjeve që përmirësojnë infrastrukturën për secilën prej njësive vijuese:

Rajonet e qytetit Shkodër. Rregullim dhe mirëmbajtje e trotuarve, vendosje e sinjalistikës rrugore. Investime në fusha sporti, ambiente rekreative dhe të korsive për lëvizjen me biçikletë. Pastrimi i vazhdueshëm i liqenit dhe zgjidhjen e problemit të kafshëve endacake në qytet.

Bërdicë, Gur i Zi dhe Postrribë. Investime në rrugët dytësore dhe rrugët lidhëse, si dhe në trotuare dhe sinjalistikë.

Dajç. Investime në rrugët dytësore dhe rrugët lidhëse, si dhe në trotuare dhe sinjalistikë.

Zgjidhje përfundimtare për problemin e përmytjeve dhe ndalim i ndërtimeve pa leje.



DIMENSIONI SOCIAL

PROGRAME DHE SHËRBIME PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Në tërësi të gjithë pjesëmarrësit në forume ishin të informuar mbi punën e Bashkisë për të mbështetur individët në nevojë për shërbime. Në njësinë administrative Bërdicë ku nuk ka aktualisht shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura u vlerësua nevoja për ngritjen e tyre, sikurse në Dajç u theksua se qendra komunitare është pak e aksesueshme për shkak të largësisë së saj. E përbashkëta e forumeve ishte kërkesa e shprehur për të zgjeruar rrjetin e shërbimeve për individët në nevojë, si dhe për të përmirësuar shërbimet aktuale.

Prioritet 14. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe në mënyrë të veçantë:

Rajonet e qytetit Shkodër. Zgjerim i shërbimeve egzistuese dhe lehtësira si karta e studentit dhe incentiva të tjera për studentët.

Dajç. Qendër multifunkionale rekreative në qendër të zonës që të jetë e aksesueshme për të gjithë individët në nevojë.
Bërdicë. Ngritje e një qendre komunitare multifunkionale.

DEMOKRACIA VENDORE

PJESËMARRJA E KOMUNITETIT NË VENDIMARRJE

Nga diskutimet mbi këtë çështje në forumet e zhvilluara rezulton se Bashkia ndërmerr procese konsultimi me komunitetin për vendimarrjet më të rëndësishme, porse mekanizmi që përdor për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në to nuk është tërësisht efektiv. Pjesa dërmuese e pjesëmarrësve në forume nuk kanë qenë ndonjëherë të përfshirë në procese të tilla, kryesisht sepse nuk kanë marrë njoftim. Ka zona ku në takime të tilla nuk merr pjesë komuniteti drejtpërdrejtë, por kryepleqtë si përfaqësues të tyre dhe ndërkohë në po ato zona pjesëmarrësit u shprehën se nuk i njohin kryepleqtë. "Nuk kemi marrë pjesë në takime konsultuese, sepse nuk jemi njoftuar që këto takime janë të hapura. Nuk mendojmë se mendimi ynë mund të merret në konsideratë"- u shprehën pjesëmarrësit në forumin e njërit prej rajoneve të qytetit Shkodër.

Prioritet 15. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit,
- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese
- mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese
- raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet



ZHVILLIMI EKONOMIK

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS

Pjesëmarrësit në forume nuk ishin në dijeni të incentivave apo programeve që mund të zbatojë Bashkia Shkodër për nxitjen e biznesit, si një mënyrë për të krijuar vende të reja pune. Në diskutime ata theksuan nevojën që Bashkia të ketë një rol real në këndvështrimin e masave që nxisin punësimin.

Prioritet 16. Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës

PAGESA E TAKSAVE NGA QYTETARËT

Pjesëmarrësit në forumet e zhvilluara theksuan se taksat paguhen rregullisht. "Nuk ofrohet shërbim nëse nuk paguajmë taksat"- u shprehën ata.

Në Dajç pjesëmarrësit konsideruan se shohin si problem vetëm mbledhjen e taksës së tokës.

Prioritet 17. Fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e taksave lokale

DIMENSIONI SOCIAL

PROGRAME DHE SHËRBIME MBI ADRESIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Nga diskutimet e zhvilluara në të gjitha Forumet mbi këtë çështje vihet re se informimi i komuniteteve në lidhje me angazhimin e Bashkisë për adresimin e dhunës në familje është i ndryshëm në zona të ndryshme. Vetëm 50% e pjesëmarrësve në forume ishin të informuar mbi fushata informimi dhe egzistencën e programeve që ndjek Bashkia për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. "Nuk kemi dijeni, por si fenomen është shumë i rrallë"- u shprehën pjesëmarrësit në forumin e Bërdicës.

Në Postribë pjesëmarrësit në forum u shprehën se dhuna në familje mbahet e fshehur, mbetet brenda familjes. Në njësitë administrative ku aktualisht nuk egzistojnë qendrat komunitare pjesëmarrësit shprehën nevojën për të ngritur shërbime për mbështetjen e viktimave të dhunës, ndërkohë në njësitë e tjera u shpreh nevoja për të zgjeruar programet egzistuese.

Prioritet 18. Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj

Prioritet 19. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet, në çdo njësi administrative, të strukturave të shërbimeve sociale

Prioritet 20. Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje

PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMARRJE

E përbashkëta e të gjitha forumeve në lidhje me pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje është kërkesa për të rritur nivelin aktual të pjesëmarrjes së tyre veçanërisht në Këshillin Bashkiak. "Në përputhje me ligjin përfaqësimi i grave në kuotën 30% është i detyruar me ligj, por mendojmë se nuk është i mjaftueshëm". Në Forumet e njësive administrative Dajç dhe Gur i Zi pjesëmarrësit u shprehën se në këshillin bashkiak aktualisht nuk ka asnjë përfaqësuese grua nga komuniteti i njësive të tyre administrative.

Prioritet 21. Programe ndërgjegjësuere që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje

ROMËT DHE EGJIPTIANËT

Mungesa e informimit mbi punën e Bashkisë për integrimin dhe fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian ishte e dukshme në 85% të forumeve të zhvilluara. "Ka programe për komunitetin romë dhe egjiptian, por nuk zbatohen në mënyrë korrekte"- u shprehën pjesëmarrësit në Forumin e një prej rajoneve të Shkodrës. Në të gjitha forumet u theksua nevoja që Bashkia të zhvillojë programe që nxisin në mënyrë të veçantë fuqizimin dhe riintegrimin social të këtij komuniteti.

Prioritet 22. Zbatim me prioritet i programeve që nxisin riintegrimin dhe fuqizimin ekonomik të komunitetit romë dhe egjiptian

● DEMOKRACIA VENDORE ●

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Pjesëmarrësit në forume në njësitë administrative u shprehën se informoheshin për vendimet e Bashkisë përmes këndit për shpalljen e njoftimeve publike. Në Bërdicë pjesëmarrësit u shprehën se edhe pse këndi i njoftimit egziston ai nuk përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Në forumin e njësisë administrative të Gurit të Zi pjesëmarrësit theksuan se mjetet e informimit egzistojnë, por interesimi i banorëve është i vogël. Në Forumet e rajoneve të qytetit Shkodër pjesëmarrësit u shprehën se rrugët që përdor Bashkia për të bërë transparent aktivitetin e saj janë të mjaftueshme.

Prioritet 23. Zhvillimi më tej i mekanizmave që mbajnë në konsideratë mundësitë e komuniteteve për ta marrë informacionin dhe që mundësojnë transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Në 85% të forumeve të zhvilluara pjesëmarrësit u shprehën të kënaqur me informacionin që marrin pranë strukturave të Bashkisë. Ata nuk ndejnë vështirësi për të patur akses në dokumenta apo marrë informacion për çështje që janë në interes të tyre dhe procedurat janë të thjeshta.

Në një prej forumeve të rajoneve të qytetit Shkodër pjesëmarrësit u shprehën se *"Personeli i Bashkisë është i rezervuar në dhënien e informacionit dhe koha e shërbimit është e papërshtatshme"*.

Prioritet 24. Çdo informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

● SHËRBITIMET PUBLIKE ●

KOPSHTET DHE ÇERDHET

Në rajonet e qytetit të Shkodrës mendimi i pjesëmarrësve në forume ishte i ndryshëm. Në njërin prej forumeve pjesëmarrësit u shprehën se kushtet në kopshte dhe çerdhe janë të përshtatshme dhe në forumin tjetër pjesëmarrësit vlerësuan se vetëm në disa kopshte janë kryer investime të mira, por është i nevojshëm vijimi i investimeve edhe në kopshtet e çerdhet e tjera të qytetit.

Në Bërdicë dhe Dajç pjesëmarrësit në Forume vlerësuan se gjendja e kopshteve është e mirë. Në forumin e njësisë administrative Gur i Zi pjesëmarrësit theksuan se *"nuk ka ndërtesa specifike për kopshte. Kopshti zhvillohet pranë shkollës së Gurit të Zi ku ka zenë dy klasa duke krijuar problem. Çerdhe nuk ka."* Mungesa e çerdheve u theksua edhe në forumin e njësisë administrative Postrisë, ndërkohë që në lidhje me kopshtet pjesëmarrësit u shprehën të kënaqur me kushtet egzistuese.

Prioritet 25. Rikonstruksion i kopshteve dhe çerdheve egzistuese në qytetin e Shkodrës, sipas nevojave të identifikuar, dhe i kopshtit në Gur të Zi

PYJET DHE KULLOTAT

Në lidhje me këtë çështje u diskutua në forumet e zhvilluara në njësitë administrative Bërdicë, Dajç, Gur i Zi dhe Postrisë. Në forume pjesëmarrësit në Bërdicë dhe Dajç theksuan mungesën e masave për të parandaluar zjarret, si dhe pamjaftueshmërinë e drurit për ngrohje si për shkollat ashtu edhe për banorët.

Në Dajç dhe në Gur të Zi blegtoaria nuk është e zhvilluar, prandaj dhe nuk ka nevoja për kullota- u shprehën pjesëmarrësit në këto forume.


Prioritet 26. Marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve në njësitë administrative Bërdicë dhe Dajç



**POP
2019**

**PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE**

KONTRATA SOCIALE



Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

